

Irlandë



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration



ÇFARË DUHET TË DINI KUR BËNI SËRISH KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE (KËRKESA E MËVONSHME)



ALBANIAN

Tani ndodheni në Irlandë, i cili është një vend i BE+.

Vendet e BE+ janë:



27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE): Austria, Belgjika, Bullgaria, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Italia, Kroacia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Polonia, Portugalia, Qipro, Republika e Irlandës, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe



4 vende të tjera: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.



PËRMBAJTJA

Çfarë është një kërkesë e mëvonshme?	3
Në se konsiston procedura?	
➤ Hapi 1: kërkesa juaj duhet të regjistrohet dhe të depozitohet sërish	5
➤ Hapi 2: shqyrtimi paraprak i kërkesës suaj	9
➤ Hapi 3: shqyrtimi i themelit të kërkesës suaj	11
➤ Hapi 4: vendimi lidhur me kërkesën tuaj	12
Cilat janë të drejtat e mia?	13
Cilat janë detyrimet e mia?	17
Cilat janë pasojat nëse nuk përmbush detyrimet e mia?	21
Ju do të përfitoni mbështetje të veçantë nëse keni nevojë	23
Po nëse dëshironi të ktheheni në vendin tuaj?	24

➤ ÇFARË ËSHTË NJË KËRKESË E MËVONSHME?

Kur e përsërisni një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare (që njihet edhe si azil) dy ose më shumë herë në një vend të BE+, kërkesa juaj e re quhet kërkesë e mëvonshme.

Kërkesa juaj e re përbën kërkesë të mëvonshme edhe nëse kërkesa e mëparshme është bërë në një vend tjetër të BE+.

Kërkesa e mëvonshme nuk përbën apelim të vendimit të mëparshëm që është marrë për kërkesën tuaj. Ju mund të bëni një kërkesë të mëvonshme vetëm kur procedura në lidhje me kërkesën tuaj të mëparshme të jetë finalizuar. Kjo do të thotë se:

- është marrë tashmë një vendim për kërkesën tuaj të mëparshme
- nuk ka asnjë apelim të hapur, dhe
- afati kohor për depozitimin e një apelimi ka kaluar.

Thjesht mosdakordësia me vendimin e mëparshëm nuk përbën arsye për të bërë sërish një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.

Nëse bëni një kërkesë të mëvonshme, duhet të paraqisni **elementet e reja (si provat ose dokumentet)** që mbështesin pretendimin tuaj se keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.



Elementet e reja janë elemente që mbështesin pretendimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare dhe që ju nuk keni mundur t'i paraqisnit me kërkesat tuaja të mëparshme.



Elementet e reja mund të jenë dokumente ose prova të reja që keni mbledhur ose ngjarje që kanë ndodhur pas datës së vendimit lidhur me kërkesën tuaj të fundit, si për shembull:

- ngjarje të reja që ju kanë ndodhur
- ngjarje të reja që kanë ndodhur në vendin tuaj të origjinës
- ndryshime të rrethanave tuaja personale.

Në raste përjashtimore, elementet e reja mund të jenë edhe elemente që ekzistojnë në kohën e kërkesës suaj të mëparshme, por vetëm nëse bëhet fjalë për njërin prej arsyeve të mëposhtme.

- Ishte e pamundur që ju të kishit dijeni për këto elemente të reja në kohën e kërkesës suaj të mëparshme.
- Për arsye të justifikuara, ju e kishit të pamundur të flisnit në lidhje me këto elemente të reja. Në këtë rast, do t'ju duhet t'i shpjegoni këto arsye.

Informacioni që keni paraqitur me kërkesën tuaj të mëparshme do të merret në konsideratë. Megjithatë, kërkesa juaj e mëparshme nuk do të shqyrtohet sërish.

NË SE KONSISTON PROCEDURA?

Pas njoftimit të autoriteteve se keni bërë sërish kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare (që quhet kërkesë e mëvonshme), procedura përfshin disa hapa.

Hapi 1. Kërkesa juaj duhet të regjistrohet dhe të depozitohet sërish

Regjistrimi dhe depozitimi përfshijnë aspektet e mëposhtme.



Do t'ju merren gjurmët e gishtërinjve.



Do t'ju bëhet një fotografi.



Do t'ju kërkohet të paraqisni të gjitha dokumentet e identifikimit, të udhëtimit dhe dokumente të tjera përkatëse, si dhe dokumente të tjera që ju zotëroni.



Do t'ju kërkohet të jepni të dhënat tuaja të kontaktit (adresën, një numër telefoni dhe një adresë emaili).



Do t'ju bëhen disa pyetje në lidhje me shëndetin tuaj dhe çdo dobësi për të parë nëse keni nevojë për ndonjë mbështetje të veçantë.



Mund t'i nënshtroheni një kontrolli fizik, si dhe kontrollit të sendeve tuaja vetjake. Sendet tuaja vetjake mbeten pronë e juaja dhe do t'ju kthehen, me përjashtim të atyre që konsiderohen si të rrezikshme.



Do t'ju kërkohet që

- të jepni të dhënat tuaja personale dhe informacione në lidhje me pjesëtarët e familjes suaj që banojnë në këtë vend ose në një vend tjetër të BE+ (nëse ka);
- të shpjegoni arsyet pse e keni bërë kërkesën e mëvonshme.



Do t'ju kërkohet që të kryeni veprimet e mëposhtme.

- Të paraqisni të gjithë informacionin dhe të gjitha dokumentet e disponueshme për të mbështetur kërkesën tuaj. Kjo përfshin elementet e reja në bazë të të cilave keni bërë kërkesën e mëvonshme. Elementet e reja mund të jenë fakte ose prova të reja që sugjerojnë se ju keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.
- Përgjigjiuni pyetjeve në lidhje me kërkesat tuaja të mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare.



Çdo informacion që ndani me autoritetet do të mbetet konfidencial. Ky informacion nuk do të ndahet në asnjë rast me personat nga të cilët po kërkoni mbrojtje.

➤ KUR DHE KU DO TË BËHET REGJISTRIMI DHE DEPOZITIMI I KËRKESËS SUAJ?

Kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare do të regjistrohet në Qendrën e Pritjes Citywest. Regjistrimi duhet të bëhet jo më shumë se 10 ditë pas bërjes së kërkesës ose përfundimit të ekzaminimit.

Pasi kërkesa juaj të jetë regjistruar, ju duhet ta depozitoni atë pranë regjistrohet në Qendrën e Pritjes Citywest në datën dhe në orën që do t'ju komunikohet gjatë regjistrimit.

Depozitimi i kërkesës suaj duhet të bëhet jo më vonë se 21 ditë pas datës së regjistrimit të kërkesës suaj.

Është shumë e rëndësishme që ju ta depozitoni kërkesën tuaj. Nëse nuk e depozitoni kërkesën tuaj, ajo do të konsiderohet si e tërhequr, me përjashtim të rastit kur arsyeja për këtë mosdepozitim është përtej kontrollit tuaj. Kjo do të thotë se do ta humbni statusin tuaj si kërkues, të drejtën tuaj për mbështetje dhe shërbime dhe të drejtën për të qëndruar në këtë vend.





Pas regjistrimit, do të merrni një dokument zyrtar që konfirmon se kërkesa juaj është paraqitur dhe regjistruar. Pasi të keni dorëzuar kërkesën tuaj, do të merrni një dokument zyrtar elektronik që konfirmon se jeni aplikant për mbrojtje ndërkombëtare. Ky dokument quhet Karta e Aplikantit për Mbrojtje Ndërkombëtare dhe mund të ruhet në telefonin tuaj. Duhet ta mbani atë me vete në çdo kohë.

Hapi 2. Shqyrtimi paraprak i kërkesës suaj



Pas depozitimit të kërkesës suaj, hapi i radhës është **shqyrtimi paraprak i saj**.

Gjatë shqyrtimit paraprak, autoritetet do të vlerësojnë nëse elementet që keni paraqitur janë realisht të reja dhe nëse këto elemente ka të ngjarë të ndryshojnë rezultatin e kërkesës suaj të mëparshme e cila është refuzuar.




Gjatë shqyrtimit paraprak, ju mund të ftoheni në një intervistë. Nëse nuk ftoheni në intervistë, shqyrtimi paraprak do të bazohet vetëm në elementet e dorëzuara në dosje.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak, kërkesa juaj mund të konsiderohet:

- **e pranueshme** ose
- **e papranueshme**.

Nëse kërkesa juaj është **e pranueshme**, ajo do të shqyrtohet më tej. Kjo do të thotë se do të ndiqni të njëjtat hapa si në procedurën standarde të azilit.

Nëse kërkesa juaj është **e papranueshme**, ajo nuk do të shqyrtohet më tej dhe procedura do të përfundojë. Autoritetet do t'ju informojnë për arsyet se përse kërkesa juaj u konsiderua e papranueshme. Për vendimin do të njoftoheni me shkrim. Nëse nuk jeni dakord me vendimin, keni mundësinë ta apelsoni atë. Për t'ju ndihmuar të apelsoni, mund të kërkonit pa pagesë një këshilltar ligjor (avokat).



Kërkesa juaj është e pranueshme nëse paraqisni **elemente të reja** në kërkesën tuaj dhe nëse këto **elemente të reja sugjerojnë se keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare**.

Kërkesa juaj është e papranueshme nëse nuk paraqisni **elemente të reja** që sugjerojnë se keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Nëse kërkesa juaj rezulton e pranueshme, do të zbatohen hapat e mëposhtëm.

Hapi 3. Shqyrtimi i themelit të kërkesës

Nëse kërkesa juaj është e pranueshme, autoritetet do të shqyrtojnë arsyet për të cilat ju po kërkon mbrojtje ndërkombëtare dhe se përse nuk dëshironi të ktheheni në vendin tuaj të origjinës (kjo procedurë njihet si shqyrtim në themel). Nëse kërkesa juaj është e pranueshme, do të ndiqen të njëjtat hapa si në procedurën standarde të azilit. Megjithatë, koha për të shqyrtuar kërkesën tuaj të mëvonshme mund të përshejtohet.



Ju do të ftoheni për një intervistë personale, përveç nëse autoriteti mund të marrë direkt një vendim pozitiv bazuar në elementet në dosjen tuaj.

EKZAMINIMI MJEKËSOR



Autoritetet mund t'ju kërkojnë t'i nënshtroheni një ekzaminimi mjekësor në lidhje me shenja të persekutimit në të kaluarën ose të dëmtimeve serioze. Ekzaminimi është pa pagesë dhe do të kryhet vetëm me pëlqimin tuaj.

Ju do të informoheni në lidhje me rezultatet e ekzaminimit, të cilat do të merren parasysh në vlerësimin e kërkesës suaj. Nëse autoritetet nuk ju kërkojnë ekzaminim, ju mund të kërkon ekzaminim me shpenzimet tuaja.

Një ekzaminim i kryer me kërkesën tuaj nuk e pengon autoritetin të vazhdojë me marrjen e vendimit të tij.

Hapi 4. Vendimi për kërkesën tuaj



Autoritetet do t'ju njoftojnë me shkrim nëse ju është garantuar mbrojtje ndërkombëtare apo jo.

Një vendim me shkrim do t'ju dërgohet përmes llogarisë suaj elektronike në Portalin e Mbrojtjes Ndërkombëtare, ose me postë apo email tek ju ose tek këshilltari juaj ligjor, nëse keni një të tillë.



MUNDËSIA PËR APELIM

Nëse nuk jeni dakord me vendimin, mund ta apeloni atë.

Kjo do të thotë se Tribunali për Ankesat lidhur me Azilin dhe Kthimet (TARA) do ta rishqyrtojë vendimin. Ju mund të kërkonj një këshilltar ligjor pa pagesë për t'ju ndihmuar me paraqitjen e ankesës suaj.

CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA?

E DREJTA PËR TË QËNDRUAR DHE PËR TË PËRFITUAR MBËSHTETJE DHE SHËRBIME PRITJEJE

Nëse kjo është kërkesa juaj e parë e mëvonshme, në parim ju lejohet të qëndroni në këtë vend derisa të përfundojë shqyrtimi i kërkesës suaj.

 **Ju mund të mos lejoheni të qëndroni gjatë shqyrtimit të kërkesës suaj nëse:**

- kjo është kërkesa juaj e mëvonshme e dytë ose e mëtejshme; ose
- keni kërkuar mbrojtje ndërkombëtare vetëm për të vonuar largimin tuaj të menjëhershëm nga ky vend.

 **Mund të mos lejoheni të qëndroni gjatë procedurës së apelimit** Në këtë rast, do të informoheni nga autoritetet për arsyet dhe nëse mund të kërkonti autorizim për të qëndruar gjatë procedurës së apelimit dhe mënyrën se si.

Gjatë qëndrimit tuaj, do të përfitoni **mbështetje dhe shërbime pritjeje**; megjithatë, këto **mund të jenë të kufizuara** në bazë të një vendimi individual nga autoriteti përkatës. Informacione të mëtejshme në lidhje me mbështetjen dhe shërbimet e pritjes që do të përfitoni mund t'i gjeni në një broshurë të veçantë.



JU KENI TË DREJTËN E SHËRBIMEVE TË PËRKTHIMIT



Nëse nuk flisni anglisht, një përkthyes do t'ju ndihmojë të komunikoni me autoritetet gjatë regjistrimit dhe depozitimit të kërkesës suaj, si dhe gjatë intervistës suaj personale, nëse zhvillohet një e tillë. Shërbimi i përkthimit është pa pagesë.


KENI MUNDËSINË TË KËRKONI QË PËRKTHYESI DHE INTERVISTUESI PËR INTERVISTËN TUAJ PERSONALE TË JENË MASHKULL OSE FEMËR, NËSE KJO JU NDIHMON TË SHPREHENI LIRISHT



Në varësi të arsyeve që do të jepni dhe nëse ka disponueshmëri, kërkesa juaj do të plotësohet.

JU KENI TË DREJTËN TË INFORMOHENI DHE TË KËRKONI KËSHILLIM LIGJOR FALAS

Ju mund të kërkonti këshillim ligjor, pa pagesë, gjatë procedurës së azilit.



Megjithatë, **ju mund të mos keni të drejtë për këshillim ligjor falas nëse:**

- e keni paraqitur kërkesën tuaj të mëvonshme vetëm për të "ndaluar" një procedurë kthimi, ose
- kjo është kërkesa juaj e mëvonshme e dytë ose e mëtejshme.

Mund të kërkonti informacion dhe këshilla ligjore në Qendrën e Pritjes Citywest në Shërbimin Këshillues të Bordit të Ndhmës Ligjore Citywest.

JU MUND TË KONSULTOHENI GJITHASHTU ME NJË KËSHILLTAR LIGJOR (AVOKAT) [ME SHPENZIMET TUAJA]

Një përfaqësues ligjor është një person që ju ofron ndihmë ose përfaqësim personal ligjor në marrëdhëniet me autoritetet. Është e drejta juaj të konsultoheni me një këshilltar ligjor në çdo fazë të procedurës së azilit me shpenzimet tuaja.



Ju mund të kërkonti një përfaqësues ligjor nga Bordi i Ndhmës Juridike. Një përfaqësues ligjor do t'ju caktohet pa pagesë dhe mund t'ju ofrojë këshilla ligjore para intervistës suaj, si edhe këshilla për çdo çështje që lind gjatë procesit. Nëse merrni një vendim negativ dhe dëshironi të bëni ankesë, përfaqësuesi ligjor do t'ju ndihmojë me paraqitjen e ankesës, përgatitjen për ankesën dhe do të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit të ankesës në emrin tuaj, në rast se zhvillohet një seancë dëgjimore me gojë.

Nëse preferoni një këshilltar ligjor të caktuar, ndani detajet e kontaktit të tyre me autoritetet sa më shpejt që të jetë e mundur. Jepuni të dhënat e këshilltarit tuaj ligjor aktual autoriteteve, në mënyrë që ata të mund ta mbajnë të informuar rreth kërkesës suaj.

JU MUND TË KOMUNIKONI ME AGJENCINË E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR REFUGJATËT (UNHCR) OSE ME ORGANIZATA TË TJERA

Ju mund të kontaktoni dhe të komunikoni me UNHCR-në ose organizatat e saj partnere në çdo hap të procedurës së azilit.



UNHCR-ja mbron interesat dhe të drejtat e azilkërkuesve dhe refugjatëve. UNHCR-ja ose organizatat e saj partnere ofrojnë gjithashtu informacion dhe ndihmë për azilkërkuesit.

Detajet e kontaktit të UNHCR-së, si dhe informacioni mbi procedurën e azilit mund të gjenden në faqen e internetit të UNHCR-së <https://help.unhcr.org/>

Ju mund të kontaktoni po ashtu çdo organizatë tjetër që ofron këshillim ligjor ose këshillim tjetër për kërkesit.

CILAT JANË DETYRIMET TUAJA?

RESPEKTONI LIGJET E VENDIT



QËNDRONI NË VENDIN KU KENI PARAQITUR KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE



Mos u përpiqni të shkoni në një vend tjetër të BE+. Ju lejohet të udhëtoni në një vend tjetër të BE+ vetëm nëse autorizoheni për këtë nga autoritetet.

SIGUROHUNI QË AUTORITETET TË MUND T'JU KONTAKTOJNË DHE QË T'I NDIQNI TAKIMET TUAJA



Ju duhet të merrni pjesë në të gjitha takimet, duke u paraqitur personalisht, sa herë që ju kërkohet nga autoritetet. Duhet të jeni atje në kohë. Nëse nuk jeni në gjendje të merrni pjesë në një takim për një arsye serioze, informoni menjëherë autoritetet dhe shpjegoni arsyen.



BASHKËPUNONI PLOTËSISHT ME AUTORITETET

Kur kërkohet, ju duhet të bëni sa më poshtë.

- Të jepni të dhënat personale, dokumentet dhe informacione të tjera të rëndësishme për të mbështetur kërkesën tuaj.



- Të jepni dokumentet e identitetit. Nëse nuk i dispononi, shpjegoni arsyen përse.



- T'i nënshtroheni procesit të marrjes së gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografimit.



- Të depozitoni kërkesën tuaj në një datë dhe vendndodhje të caktuar.
- Të merrni pjesë në intervistën personale dhe t'u përgjigjeni pyetjeve gjatë intervistës.



- Të pranoni t'i nënshtroheni kontrollit fizik dhe të sendeve vetjake, nëse autoritetet ju kërkojnë ta bëni këtë. Kontrollat do të kryhen vetëm kur është e nevojshme dhe e justifikuar. Autoriteti do t'ju shpjegojë arsyet e kontrollit. Kontrolli do të kryhet nga një person i së njëjtës gjini si ju dhe do të bëhet në një mënyrë që respekton dinjitetin tuaj.

TREGONI TË VËRTETËN



Ajo që thoni është shumë e rëndësishme për besueshmërinë e kërkesës suaj. Kjo është arsyeja përse ju duhet të jeni të sinqertë dhe të jepni informacion të plotë dhe të saktë në lidhje me identitetin tuaj, familjen, vendin e origjinës dhe arsyet e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Mund të mos mbani mend gjithçka dhe mund të mos jeni në gjendje t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve. Nëse është kështu, shpjegoni se nuk mbani mend dhe mos jepni përgjigje të menduara aty për aty.

JEPNI TË DHËNA TË SAKTA KONTAKTI DHE SIGUROHUNI QË TË MUND T'JU KONTAKTOJNË



Autoritetet duhet të jenë në gjendje t'ju kontaktojnë në lidhje me kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.

Nëse adresa juaj, emaili ose numri i telefonit ndryshojnë, informoni menjëherë autoritetet.

Ju mund t'i njoftoni autoritetet për çdo ndryshim duke dërguar një email në contact@ipo.gov.ie.

! Mbani mend, nuk duhet të largoheni nga Irlanda ndërkohë që kërkesa juaj është duke u shqyrtuar.

Nëse jeni akomoduar në një qendër, nuk duhet të zhvendoseni diku tjetër pa lejen e autoriteteve.

DORËZONI TË GJITHA INFORMACIONET DHE DOKUMENTET QË MBËSHTETIN APLIKIMIN TUAJ NË ZYRËN E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

Ka mundësi që të mos thirreni për intervistë personale dhe që procedura të zgjasë shumë pak, vetëm disa ditë ose vetëm disa orë madje. Prandaj, është e rëndësishme që t'u tregoni autoriteteve pa vonesë të gjitha arsyet dhe elementet e reja për të cilat po paraqisni përsëri kërkesë.

Kurdoherë që është e mundur, duhet të paraqisni dokumentet origjinale. Është e ndaluar të dorëzoni dokumente të rreme.




Ju duhet të dorëzoni të gjitha informacionet dhe dokumentet sa më shpejt të jetë e mundur kur paraqisni kërkesën tuaj. Nëse nuk i keni dokumentet menjëherë në dispozicion, duhet t'i dorëzoni ato sapo t'i keni ose brenda 5 ditëve pas intervistës suaj, nëpërmjet llogarisë suaj elektronike në Portalin e Mbrojtjes Ndërkombëtare ose me email në contact@ipo.gov.ie.



CILAT JANË PASOJAT NËSE NUK I PËRMBUSHNI DETYRIMET TUAJA?

PROCEDURA JUAJ E AZILIT DO TË NDËRPRITET



Kërkesa juaj do të konsiderohet e **tërhequr ose e refuzuar**. Kjo do të thotë se ju mund të humbni statusin tuaj si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare dhe të gjitha të drejtat e lidhura me të.

Kjo do të ndodhë nëse refuzoni:

- të jepni informacion kur ju kërkohet ta bëni këtë gjë
- t'i nënshtroheni procesit të marrjes së gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografimit
- të jepni adresën tuaj
- t'u përgjigjeni pyetjeve gjatë intervistës suaj personale, nëse do të zhvillohet një e tillë

Kjo do të ndodhë edhe nëse ju:

- nuk e depozitoni kërkesën tuaj brenda afatit të caktuar kohor, pa pasur ndonjë arsye serioze
- nuk merrni pjesë në intervistën personale, pa pasur ndonjë arsye serioze
- nuk raportoni tek autoritetet kur ju kërkohet
- nuk qëndroni në vendin ku jeni të detyruar të qëndroni
- nuk mund të kontaktoheni nga autoritetet
- largoheni nga vendi.

Gjithashtu, ju mund të vendosni ta tërhiqni kërkesën tuaj në çdo kohë gjatë procedurës së azilit, për shembull, sepse keni vendosur të ktheheni në vendin tuaj. Në këtë rast, ju do të humbisni statusin tuaj si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare.

DISA LLOJE TË MBËSHTETJES DHE SHËRBIMEVE TË PRITJES MUND TË REDUKTOHEN OSE TË ANULOHEN



Në disa rrethana, autoritetet mund të vendosin të reduktojnë ose të anulojnë disa lloje mbështetjeje ose disa shërbime. Autoritetet do t'ju informojnë me shkrim për një vendim të tillë pasi të vlerësojnë situatën tuaj.

Do të mund të gjeni informacion të mëtejshëm në një broshurë të veçantë.

KËRKESA JUAJ MUND TË NDIKOHET NEGATIVISHT

Nëse jepni informacion keqorientues ose të rremë në lidhje me identitetin ose kërkesën tuaj, ose nëse shkatërroni apo falsifikoni dokumente, kjo mund të ndikojë negativisht në kërkesën tuaj, për shembull si më poshtë.



- Kërkesa juaj mund të refuzohet dhe mund të mos përfitoni mbrojtje ndërkombëtare.

- Kërkesa juaj mund të shqyrtohet me anë të procedurës në kufi për azilin (në rast të tillë, do të merrni informacion specifik për procedurën).

Nëse autoritetet zbulojnë më vonë se nuk keni thënë të vërtetën gjatë procedurës së azilit, mund t'ju hiqet edhe mbrojtja ndërkombëtare.

JU DO TË PËRFITONI MBËSHTETJE TË VEÇANTË NËSE KENI NEVOJË

Ju duhet të informoni autoritetet, sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse keni nevojë për mbështetje të veçantë. Këto nevoja mund të lindin nga një larmi situatash, të tilla si shtatzënia, sëmundjet ose përvojat e dhunës psikologjike, fizike ose seksuale.

Autoritetet do të vlerësojnë situatën tuaj dhe mund të ofrojnë mbështetje shitesë për të lehtësuar pjesëmarrjen tuaj në procedurën e azilit. Për shembull, ata mund të caktojnë staf të specializuar për rastin tuaj.



➤ PO NËSE DËSHIRONI TË KTHEHENI NË VENDIN TUAJ?

Në çdo kohë gjatë procedurës së azilit, ju mund të vendosni të ktheheni vullnetarisht në:

- vendin tuaj ose
- një vend transit apo një vend tjetër të tretë, nëse keni të drejtën ta bëni këtë.

Mund të merrni ndihmë me fluturimet, dokumentet e udhëtimit dhe rregullimet e udhëtimit. Mund të merrni edhe ndihmë financiare, në varësi të kriterëve të përfitimit.

Nëse vendosni të ktheheni vullnetarisht, procedura juaj e azilit do të ndërpritet dhe nuk do të keni më të drejtë të qëndroni në Irlandë.

Nëse dëshironi të ktheheni vullnetarisht, kontaktoni Njësinë e Kthimeve Vullnetare në Qendrën e Akomodimit Citywest me email në volunteerreturns@justice.ie ose me telefon në +353 87 403 1651. Mund të merrni informacion, si dhe ndihmë për kthimin tuaj të sigurt dhe të ligjshëm





KONFIRMIMI I MARRJES SË INFORMACIONIT

Një nëpunës do t'ju kërkojë të konfirmoni se e keni marrë këtë Informacion.

Nëse nuk e keni kuptuar diçka ose nëse keni pyetje shtesë, mos hezitoni asnjëherë të pyesni.



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

Kjo broshurë është vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA-ja vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë faqe nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA-ja dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.

© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin, 2025